

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ELBAFRUIT ” SHPK

Bazuar ne vullnetin e ortakut themelues dhe mbeshtetur ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ndryshuar me Ligjin nr. 10 475, date 27.10.2011, vendoset si me poshte:



Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja dhe Selia e Shoqerise.

Neni 1:

Themelimi, Themeluesit, Emri.

Sot me date 24/05/2021 themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin

“ELBAFRUIT ” SHPK

Themeluesi i shoqerise **“ELBAFRUIT ” SHPK**, eshte themeluar nga ortaku i vetem **Aleksander Hoxha**, atesia Hasan, lindur me 24.06.1983 , mbajtes i leternjoftimit nr.028067025, numer personal I30624015M, banues ne lagja “Sul Papri ”, Elbasan, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Neni 2:

Objekti i Shoqerise.

- Objekti i veprimtarise i Shoqerise **“ELBAFRUIT ” SHPK do te jete:**

Prodhim perpunim, shperndarje fruta perime dhe eksport produktesh. Import eksport i te gjitha llojeve te mallrave industriale, ushqimore, tregtim i tyre me shumice dhe me pakice. Zhvillim i cdo aktiviteti tregtar e financiar qe i sherben realizimit te objektit te aktivitetit. Import eksport dhe tregtim te mallrave te akcizes. Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e pakice te ushqimeve per njerez me origjine shtazore. Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e fruta perimeve, paketimi i tyre dhe eksportimi.

Neni 3:

Kohezgjatja e shoqerise.

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje periudhe te pacaktuar.

Neni 4:

Selia e shoqerise


Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **“ELBAFRUIT ” SHPK**, ka seline e saj ne ne Elbasan , ne nr. Pasurie 666/5; zona kadastrale 8526, lagja lagja Fushe Ure, Elbasan. Shoqeria mund te kryeje e te transferoje, apo te suprimoje qendra administrative, seli, filiale, agjensi dhe zyra ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte vendit.

Kreu II

Kapitali i shoqerise.

Neni 5:

Vlera dhe pagesa e kapitalit te paguar

Aleksander Hoxha  1



Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2 000 000 (dy milion) leke. Pjesemarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tij si vijon :

Lloji i kontributit eshte ne para ne vleren 2 000 000 (dy milion) leke, i ndare ne 1 kuote ne vleren 2 000 000 (dy milion) leke, e cila perben 100% vleren e kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte shlyer dhe nenshkruar teresisht nga ortaku i shoqerise.

Kreu III

Administratori i shoqerise.

Neni 6:

Emerimi dhe kohezgjatja e Administratorit.

Asambleja e pergjithshme zgjedh nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise per nje periudhe pese vjecare (5vjet), ne pajtim me parashikimet e Ligjit 9901 date 14.04.2008, i ndryshuar. Emertimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te marre me shumice te zakonshme nga Asambleja e Pergjithshme.

Administratori i pare i shoqerise per nje periudhe 5 (vjet) vjecare do te jete, Z. Aleksander Hoxha njekohesisht dhe ortaku i vetem i saj.

Kreu IV

Dispozitat Perfundimtare.

Neni 7:

Marredheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet kontrates se punesimit qe lidhet midis paleve ne mbeshtetje te Kodit te Punes si dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij.

Ortaku /ortaket e shoqerise nuk kufizohen ne rritjen e kapitalit te Shoqerise.


Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private, midis ortakeve, punonjesve dhe personave te trete, kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, mbetet ne kompetence te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan.

Shoqeria do te kete vulen e saj ku jane percaktuar dhe inicialet e emertimit tragtar.

Modalitet per ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve te Asamblese se Pergjithshme, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar, etj, do te rregullohen nga Statuti i Shoqerise dhe Ligji 9901 14.04.2008 "2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar si dhe Ligji 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", i ndryshuar.

Ky akt themelimi eshte perpiluar ne kater kopje me vlere te njejete me origjinalin.

Elbasan, me date 24/05/2021



THEMELUES:

Z. Aleksander Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER FATMIR Y. KOSENI



V2021010740113463744

DATE 24/05/2021
NR REP 2486

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 24.05.2021, para meje Noter FATMIR Y. KOSENI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Elbasan, AQIF PASHA/NR.4, 28 NENTORI, NR.6/307, u paraqit personalisht:

DEKLARUES:

Aleksander Hoxha, atësia Hasan, amësia Lutfije, shtetas Shqiptar, lindur në Floq, Elbasan dhe banues në Elbasan, lindur më 24/06/1983, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035023242 dhe nr. personal I30624015M .

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noterit, Akt Themelimin e shoqërisë "ELBAFRUIT " SHPK dhe Statutin e Shoqërisë me Përgjegjesi të Kufizuar "ELBAFRUIT " SHPK , bashkëlidhur.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

FATMIR Y.T. KOSENI

Taksa e Pullës
U Paga

